



Arrestohet një person për armëmbajtje pa leje dhe posedim të narkotikëve



12/05/2023 11:23

f

t

l

Policia e Kosovës në Ferizaj ka arrestuar një 26 vjeçar të dyshuar për armëmbajtje pa leje dhe posedim të narkotikëve.

Rasti ka ndodhur mbrëmjen e së enjtes në rrugën “Hamëz Jashari” derisa policët e stacionit ishin në një pikë kontrolli dhe ndaluan një automjet me targa vendore.

“Gjatë legjitimitit të shoferit dhe kontrollimit të automjetit, policia ka gjetur një karikator me një fishek, sasi të substancës narkotike dhe një mulli për bluarjen e substancave narkotike”, thuhet në njoftimin e Policisë.

Policia gjithashtu ka bastisur banesën e të dyshuarit, ku ka konfiskuar armë dhe fishek.

“Është bastisur banesa e të dyshuarit, ku janë gjetur dy armë zjarri (pistoleta) dhe një fishek. I dyshuari G.H (M/K) i moshës 26 vjeçare është shoqëruar në stacionin e policisë në Ferizaj dhe pas intervistimit nga policët hetues, me vendim të prokurorit të rastit është ndaluar në mbajtje për 48 orë për procedura të mëtejme hetimore”, thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Rasti është iniciuar si “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve” dhe “Posedim i paautorizuar i substancave narkotike psikotrope ose analoge”.

Artikuj të ngjashëm



May 12, 2023
Zbulohet drejtori që u arrestua për nënshkrimin e kontratës së dyshimtë...



May 12, 2023
Publikohet parashikimi i motit për dy ditët e fundjavës



May 12, 2023
“Erdhi Lezeti” i Përparim Ramës ua ndërron itinerarin autobusëve urbanë...



May 12, 2023
Kritika prej vërteti ndaj “Fake News-it” të Vetëvendosjes, kjo e fundit...



May 12, 2023
Tre konkurse të dështuara për Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, kritika...



May 12, 2023
Në Vushtrri zbulohet mashtrimi i konsumatorëve me sasi të naftës

LAJME TË FUNDIT



Merr fund gjithçka, Lakers në gjysmëfinale të play-offit



Zbulohet drejtori që u arrestua për nënshkrimin e...



“Erdhi Lezeti” i Përparim Ramës ua ndërron itinerarin...



Meçi me peshat më të rënda, “boksierët” kryen matjet zyrtare

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE

f

@

t

y

Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved [Privacy Policy](#)